SEJDIU & QERKINI
SHOQËRIA E AVOKATËVE
LAW FIRM

Lagja Veternik, Kompleksi Banesor EXDC 3
Llamella 10, Kati 6, Nr. 18
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Web: www.sq-law.com
E-mail: info@sq-law.com
Tel: +383 (0) 45 40 77 40

PËR	**ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT**
NGA	**FOLEJA MOTORS LLC (ish Auto Shtëpia Siqani sh.p.k.),** një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, me numër unik identifikues 811493155 dhe seli në: Llapllasellë, Magj.Prishtinë-Shkup Km 8, p.n, Republika e Kosovës, e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve Sejdiu & Qerkini sh.p.k., me seli në: Lagja Veternik, Kompleksi Banesor EXDC3, Blloku 10, Kati 6, Nr. 18, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.
DATA	8 dhjetor 2023
LËNDA	**ANKESË ndaj Vendimit të Agjencisë Qendrore të Prokurimit, datë 04.12.2023.**

I. Hyrje

Foleja Motors LLC - ish Auto Shtëpia Siqani sh.p.k. (këtu e tutje "Parashtruesi") në cilësinë e tenderuesit ka aplikuar në tenderin e Autoritetit Kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit i cili identifikohet me numrin UA/2016-23-5626-1-1-1. Ky aktivitet titullohej: Furnizimin me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës.

Parashtruesi kishte ofertuar në 1, 2, 3, 4, 5, 6, 9 pjesët/lotet e këtij tenderi.

Me datë 25.08.2023, Parashtruesi nga ana e Autoritetit Kontraktues pranon Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar, me anë të së cilës siç edhe nënkuptohet nga titulli njoftohet se është eliminuar nga tenderi i autoritetit kontraktues.

Duke mos u pajtuar me vendimin e Autoritetit Kontraktues, Parashtruesi, kishte paraqitur kërkesën për rishqyrtim të letrës standarde. Autoriteti Kontraktues duke vendosur sipas kërkesës së Parashtruesit, kishte marrë vendimin e tij me anë të së cilit, atë ankesë e kishte refuzuar.

Në përputhje me këshillën juridike, Parashtruesi kishte paraqitur ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit – OSHP. Ky organ pas shqyrtimit të ankesës si dhe pas mbajtjes së seancës publike, me datë 27.10.2023 morri vendimin e identifikuar si OSHP: 2023/0670, me anë të së cilës është Aprovuar Pjesërisht Ankesa e Parashtruesit dhe aktiviteti i prokurimit është kthyer në Rivlerësim.

Provë 1: Vendim i OSHP-së 2023/0670, datë 27.10.2023.

Në procedurën e rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues me datë 29.11.2023, nxori Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar. Këtë dokument Parashtruesi e ka pranuar me datë 29.11.2023.

Provë 2: Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, datë 29.11.2023.

Parashtruesi duke mos u pajtuar me Letrën Standarde, brenda afatit ligjor kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtim. AK duke vendosur sipas kërkesës së Parashtruesit, me datë 04.12.2023, mori Vendimin me anë të së cilit refuzoi Kërkesën e Parashtruesit.

Provë 3: Kërkesa për rishqyrtim dhe Vendimi i AK, datë 04.12.2023.

Vendimin e AK, Parashtruesi e ka pranuar me datë 04.12.2023 dhe brenda afatit ligjor, paraqet këtë ankesë, përmes së cilës konteston në tërësi vendimin e AK dhe të njëjtin e vlerëson si të kundërligjshëm.

II. Baza Juridike

Si bazë juridike, për hartimin dhe paraqitjen e kësaj kërkese shërbeu:

- Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje "LPP");
- Ligji Nr. 04/L -237 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje "LPP I");
- Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje "LPP II");
- Ligji Nr. 05/L-092 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje "LPP III");
- Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (këtu e tutje "LPPA");
- Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (këtu e tutje "Rregullorja").

III. Arsyetimi

LPP II në Nenin 61 përmes së cilit ka riformuluar paragrafët 1 dhe 2 të Nenit 109 të LPP-së, parasheh se:

> *"1. Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.*

2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji."

3.1.Vendimi i paarsyetuar

Neni 48 i LPPA-së, parasheh se:

"1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:

1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;

1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;

1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;

1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;

1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;

1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.

2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij."

Autoriteti kontraktues, në vendimin e tij nuk jep arsyetim se cilat kanë qenë shkaqet vendimtare gjatë vlerësimit të provave. Pra, nuk tregon se çfarë dallimi dhe ndikimi ka ndryshimi i emrit në një subjekt juridik.

Në vendimin e ankimuar, poashtu nuk arsyetohet apo më mirë të themi nuk përmendet asnjë bazë ligjore e cila e mbështet vendimin e AK-së. Për më tepër AK, nuk ka zbatuar as sugjerimet e dhëna nga OSHP në vendimin e saj (prova 1). Në këtë vendim, krahas sugjerimeve është vërtetuar edhe fakti se Parashtruesi e ka pasur të pamundur të që bëjë ndryshimin e emrit në sistemin e E-Prokurimit, përderisa këtë nuk e kishte realizuar edhe pranë ATK-së (e gjithë kjo sepse procedura pranë ATK-së, ka zgjatur).

Tutje, Parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim e tij, ka treguar dhe dëshmuar me prova, shembuj, se si kanë vepruar autoritetet e tjera kontraktuese gjatë kohës kur Parashtruesi ishte në proces e sipër të ndryshimit të emrit (edhe njëherë sqarojmë numri identifikues i njëjtë, kompania e njëjtë), ku me anë të kërkesës për sqarim, kanë kërkuar nga Parashtruesi që të sqaroj çështjen e emrit. Pastaj, Parashtruesi pas ofrimit të sqarimit të mbështetur me prova, procedura e prokurimit pranë autoritetit kontraktues ka vazhduar pa eliminim të Parashtruesit. Në rastin tonë, autoriteti kontraktues nuk ka bërë kërkesë për sqarim si dhe në vendimin e ankimuar nuk e ka arsyetuar pretendimin e Parashtruesit për këtë çështje.

Prapë se prapë me gjithë sqarimet e dhëna (në 2 kërkesa për rishqyrtim) si dhe me vendimin e OSHP-së (prova 1), AK ka marrë vendim të njëjtë, personin e njëjtë juridik (verifiko numrin unik) i cili ka ndërruar emrin, nuk e llogaritë si palë të njëjtë. Nëse shohim faqen e vendit të vendimit të ankimuar, AK-ja, e pranon që numri unik identifikues është i njëjtë në të dy emërtimet e Parashtruesit, por prapë vlerëson se emri është ai që i pengon. Këtë pengesë që ka AK nuk ka mundur që ta mbështesë me bazë ligjore, ashtu që, vendimi i tyre është i kundërligjshëm.

3.2. Zbatimi i gabuar i së drejtës materiale dhe konstatimi i gabuar i gjendjes faktike

Siç është cekur sa e sa herë, Autoriteti kontraktues vendimin e saj të ri nuk e mbështetë në asnjë dispozitë materiale. Paraqitja e bazës ligjore është një detyrim ligjor, kushtetues dhe i garantuar edhe nga konventat ndërkombëtare të aplikueshme në vendin tonë, ashtu që, vetëm mungesa e bazës ligjore, është fakt i mjaftueshëm që vendimi i AK-së, të prishet.

Me qëllim të respektimit të organit vendimmarrës (OSHP) Parashtruesi do të paraqesë rrjedhën e ngjarjes së ndryshimit të emrit. Parashtruesi konkretisht aksionarët e tij, për qëllime afariste, kanë vendosur që emrin e kompanisë së tyre ta ndryshojnë nga Auto Shtëpia Siqani sh.p.k., në Foleja Motors LLC. Siç parashihet edhe me ligj, këtë kërkesë për ndryshim të emrit, fillimisht e kanë bërë pranë ARBK-së. Një ndryshim i tillë, ka përfunduar me sukses pranë ARBK-së, me datë 23.05.2023.

Provë 4: Certifikata e Biznesit dhe informatat e tij, datë 23.05.2023.

Pas realizimit të këtij ndryshimi korporativ, Parashtruesi kishte tentuar emrin e ri ta evidentoj edhe në E-Prokurimi, mirëpo ky ndryshim nuk ishte i mundur, meqë para kësaj duhet të bëhej edhe ndryshimi pranë Administratës Tatimore të Kosovës – ATK. Ky fakt është vërtetuar nga vendimi i OSHP-së (prova 1).

Marrë parasysh atë që u tha më lartë, si dhe bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Parashtruesi me datë 25.05.2023 pranë ATK-së, paraqet kërkesën për ndryshim të emrit dhe marrjen e numrit të ri fiskal.

Provë 5: Aplikimi pranë ATK-së, datë 25.05.2023

Siç edhe dihet, kjo procedurë para ATK-së, nuk përfundohet shpejtë, ashtu që, Parashtruesi meqë nuk ka mundur të ndërroj emrin në E-Prokurimi (për arsyet e cekura më lartë) dhe në tenderin e shpallur ka aplikuar me emrin që evidentohet në E-Prokurim dhe dokumentet e tjera - në emër të Auto Shtëpia Siqani sh.p.k.. E tërë kjo për shkak se ndryshimi i emrin nuk është realizuar në tërësi pranë të gjitha institucioneve shtetërore.

Me datë 10.08.2023, Parashtruesi me sukses përfundon të gjitha procedurat pranë ATK-së dhe rrjedhimisht merr certifikatën e re.

Provë 6: Certifikata e ATK-së, datë 10.08.2023.

Provë 7: Kërkesa për sqarim nga AK të tjerë.

Në të njëjtën datë, pra 10.08.2023, Parashtruesi bënë edhe ndryshimin e emrit në E-Prokurim, meqë tani kjo i është lejuar nga ana e sistemit. Kjo gjë mund të vërtetohet shumë lehtë në sistemin e E-Prokurimit (për çdo person që ka dyshime dhe qasje në sistem). Pra, Parashtruesi me përgjegjësi të plotë deklaron se në sistemin e E-Prokurimit me datë 10.08.2023, ka bërë ndryshimin e emrit nga Auto Shtëpia Siqani sh.p.k. në Foleja Motors LLC.

Si përfundim u vërtetua se autoriteti kontraktues gjatë marrjes së vendimit të atakuar me këtë ankesë, ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe pas kësaj edhe zbatim të gabuar të dispozitave materiale, ku të gjitha këto kanë rezultuar në marrjes e një vendimi të kundërligjshëm.

3.3.Dëmi material dhe pamundësia e veprimit ndryshe

Me vendimin e autoritetit kontraktues, Parashtruesi ka pësuar dhe vazhdon të pësoj dëme të konsiderueshme materiale.

Krahas dëmeve Parashtruesi është sjellë në një pozitë që sido që të kishte vepruar, prapë se prapë do të eliminohej. Në rast se do të kishte aplikuar në emrin e ri Foleja Motors LLC, do të ishte eliminuar për shkak se në sistemin e E-Prokurimit emri i saj ende do të figuronte si Auto Shtëpia Siqani sh.p.k, ndërsa kur ka aplikuar me emrin që ka pasur në sistemin e E-Prokurimit, po eliminohet për shkak se në ndërkohë ka ndryshuar emrin dhe këtë ndryshim pa fajin e saj nuk ka mundur ta bëjë në E-Prokurim.

Parashtruesi është i mendimit se e tërë kjo pjesë apo paqartësi është si rezultat i mos kërkesës për sqarim (siç kanë bërë autoritetet tjera kontraktuese) nga Autoriteti Kontraktues.

Poashtu nuk është aspekt e drejtë që pamundësitë e veprimit në sistemin e E-Prokurimit, të barten në përgjegjësi dhe eliminim për Parashtruesin. Parashtruesi vlerëson se AK në vendimin e saj është dashur të merr parasysh të gjitha rrethanat dhe mos të eliminoj Parashtruesin për këtë arsye. Këtë edhe më tepër e vërteton fakti se të gjithë pajtohemi se personi juridik është po ai i njëjti.

IV. Përfundimi dhe Kërkesa

Bazuar në dispozitat ligjore, argumentet si dhe provat e bashkangjitura është vërtetuar se autoriteti kontraktues ka marr një vendim i cili ka shkelje të theksuara procedurale, materiale si dhe ka konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Andaj, Parashtruesi, Organit Shqyrtues të Prokurimit, me respekt, i propozon që **VETË** në mënyrë meritore të vendos lidhur me këtë çështje dhe të bie këtë:

VENDIM

I. **APROVOHET** Ankesa e Foleja Motors LLC e paraqitur ndaj Vendimit të Autoritetit Kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit, datë 04.12.2023, si **e BAZUAR;**

II. **ANULOHET** Vendimi i Autoritetit Kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit datë 04.12.2023, si i **KUNDËRLIGJSHËM;**

III. **OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit që Foleja Motors LLC ta përfshijë në trajtimin e pjesëve/lotët 1, 2, 3, 4, 5, 6, 9, të aktivitetit të prokurimit të identifikuar si: UA/2016-23-5626-1-1-1.

Ankesa e hartuar dhe paraqitur me respekt nga:

Shoqëria e Avokatëve
Sejdiu & Qerkini sh.p.k.

Avokat Burim Azemi

SEJDIU& QERKINI
SHOQËRIA E AVOKATËVE
LAW FIRM

Prishtinë, 8 dhjetor 2023

Foleja Motors L.L.C. një shoqëri me përgjegjësi i kufizuar, e cila është e organizuar dhe vepron në bazë të ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, e regjistruar pranë Agjencisë për Regjistrim të Bizneseve të Kosovës (ARBK), me numër unik identifikues 811493155 dhe seli në: Llapllasellë, Magj.Prishtinë-Shkup Km 8, pn, Graçanicë, Republika e Kosovës, sot me datë 29 gusht 2023, jep këtë:

AUTORIZIM

Me të cilin autorizohet Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" Sh.P.K., me adresë në Lagjen Veternik, Kompleksi Banesor EXDC 3, Blloku 10, Kati 6, Nr.18, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, që përmes avokatëve/stafit, Artan Qerkini, Korab R. Sejdiu, Burim Azemi, Taulant Q. Hajdari, Miranda Haxhiu, Blinera Osmani, Kaltrina Kodraliu, Dior Zhuri dhe Lea Meraku të përfaqësojnë Autorizim-dhënësin në konteste civile, administrative, komerciale dhe përmbarimore, si dhe në procedurën penale dhe kundërvajtëse në Gjykatat e Republikës së Kosovës, në agjencitë e pavarura dhe në organet administrative të Republikës së Kosovës.

Të autorizuarit kanë të drejtë të ndërmarrin të gjitha veprimet juridike për të zgjidhur çështjet kontestuese, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar, në hartimin, nënshkrimin dhe paraqitjen e padisë dhe parashtresave të tjera, lidhjen e ujdisë gjyqësore, ne organet përmbarimore, paraqitjen e mjeteve juridike të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, paraqitjen e propozimit për përmbarim, të kërkojnë zbatimin e masave të përkohshme, dhe atë pranë të gjitha instancave gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në Republikën e Kosovës.

Ky autorizim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen deri sa të revokohet nga Autorizim-dhënësi.

Autorizim-dhënësi:
Për dhe të në mirë të
Foleja Motors LLC

Vijon Peja

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR Foleja Motors GRAÇANICË

Fiton Peja

Prishtinë, 29 gusht 2023.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0670

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani-Kryetare, Agon Ramadani-Referues dhe Vedat Poterqoi-Anëtar duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "Foleja Motors L.L.C." të datës 08.09.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Agjencia Qendrore e Prokurimit të datës 25.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës" me numër të prokurimit UA/2016-23-5626-1-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 27.10.2023 merr këtë:

Vendim

1.Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Foleja Motors LLC, e parashtruar me 08.09.2023, Protokolli 670/23, dhe Anulohet Vendimi i AK i datës 25.08.2023, kurse aktiviteti i prokurimit "Furnizim me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës, me numër të prokurimit UA/2016-23-5626-1-1-1, kthehet në **Rivlerësim**.

2. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emrin e tarifës ankimore kurse ankuesi ka të drejtë të parashtroj kërkesë për kthimin e mjeteve brenda afatit prej 60 ditëve nga dita e pranimit të vendimit, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Agjencia Qendrore e Prokurimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 13.06.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës" me nr. të prokurimit UA/2016-23-5626-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratëspër furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 6,900,000.00€.

Me datë 25.08.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 si dhe letrën standarde për tenderuesin e eliminuar përmes të cilës oferta e ankuesit është eliminuar si e papërgjegjshme me arsyetimin si në vijim: "*Ju keni ofertuar me emrin e biznesit Auto Shtëpia Siqani Sh.P.K. dhe të gjitha dokumentet janë me këtë emër si dhe të vulosura me këtë emër ndërsa me nr. tuaj të biznesit në ARBK figuron biznesi me emër tjetër pra biznesi me emrin Auto Shtëpia Siqani Sh.P.K. nuk figuron në ARBK*".

Me datë 29.08.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 01.09.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar në tërësi kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Me 08.09.2023, OE Foleja Motors LLC, nga cilësia e tij si ankues, ka atakuar Vendimin e AK të datës 01.09.2023, me të cilin ankuesi është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, i përshkruar si në vijim: Furnizim me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës, me numër të prokurimit UA/2016-23-5626-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën-paragrafin 75 të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:"*Parashtruesi konkretisht aksionarët e tij për qëllime afariste kanë vendosur që emrin e kompanisë së tyre ta ndryshojnë nga Auto Shtëpia Siqani Sh.P.K. në Foleja Motors LLC. Siç parashihet edhe me ligj, këtë kërkesë për ndryshim të emrit, fillimisht e kanë bërë pranë ARBK. Një ndryshim të tillë e kanë përfunduar me sukses pranë ARBK me datë 23.05.2023. Pas realizimit të këtij ndryshimi korporativ, parashtruesi kishte tentuar emrin e tij ta evidentoj edhe në E-Prokurimi, mirëpo ky ndryshim nuk ishte i mundur meqë para kësaj duhet të bëhej edhe ndryshimi pranë Administratës Tatimore të Kosovës - ATK. Siç edhe dihet, kjo procedurë para ATK nuk përfundohet shpejt ashtu që parashtruesi meqë nuk ka mundur të ndërroj emrin në E-Prokurimi edhe në tenderin e shpallur ka aplikuar me emrin që evidentohet në E-Prokurim dhe dokumentet e tjera – në emër të Auto Shtëpia Siqani Sh.P.K. E tërë kjo për shkak se ndryshimi i emrit nuk është realizuar në tërësi pranë të gjitha institucioneve shtetërore. Me datë 10.08.2023, parashtruesi me sukses përfundon të gjitha procedurat pranë ATK dhe rrjedhimisht merr certifikatën e re. Në të njëjtën datë, pra 10.08.2023 parashtruesi bënë edhe ndryshimin e emrit në E-Prokurim mqeë tani kjo është lejuar nga ana e sistemit. Pra parashtruesi me përgjegjësi të plotë deklaron se në sistemin E-Prokurimi me datë 10.08.2023 e ka bërë edhe ndryshimin e emrit*

nga Auto Shtëpia Siqani Sh.P.K. në Foleja Motors LLC".

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 14.09.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 25.09.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si vijon: "*eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK*".

Paneli konstatoi paraprakisht se Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, sikurse kërkohet me nenin 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Krahas kësaj konstatohet se palët janë të informuara reciprokisht lidhur me shkresat kësaj lënde, në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të kësaj Rregulloreje prandaj ka kushte që Paneli të vendosi në mënyrë meritore përkitazi me ankesën.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli konstatoi senuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, sikurse kërkohet me nenin 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi në vijim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të caktohet seanca publike me palë (mbajtur me 19.10.2023) sikurse parashihet me paragrafin 2 të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli Shqyrtues konstatoi më tej se AK ka aplikuar aktivitet të prokurimit procedurë te hapur, vlera e parashikuar e të cilit është 6.900.000,00 € (sikurse parashihet me nenin 9, paragrafi 1, lidhur me nenin 15, paragrafi 2, të LPP) dhe mori në administrim te gjitha shkresat e kësaj lënde, raportin e ekspertizës, faktet, provat, pohimet ankimore, i duke i analizuar dhe vlerësuar në përmbledhje si në vijim të këtij arsyetimi.

AK e ka eliminuar ankuesin nga ky ketë aktivitet i prokurimit për faktin se, cituar "...ky OE konsiderohet si palë pa interes në ketë procedurë të prokurimit pasi që AK-AQP nuk ka pranuar ofertë nga OE: Foleja Motors dhe asnjë dokument nuk ka qenë i nënshkruar apo vulosur me ketë emër të OE edhe pse Certifikata e Biznesit të OE: Foleja Motors e ngarkuar në kërkesën për rishqyrtim mban datën 23.05.2023 ndërsa aktiviteti i prokurimit është publikuar me datën 13.06. 2023". Dhe se, cituar: "...në vlerësim të ofertave është respektuar Rregullorja Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik, neni 3.16".

Kurse, Ankuesi, e ka atakuar vendimin e cituar si më sipër nga aspektet meqë i njëjti nuk i përmban elementet qenësore të vendimit sikurse parashihen ato me dispozitën e nenit 48, 1, të LPP, meqë nuk i ofron arsyet se cilat kanë qenë siç thuhet *shkaqe vendimtare* gjatë vlerësimit të provave lidhur me faktin se cilat janë efektet e ndryshimit të emrit të një subjekti juridik. Ankuesi ka theksuar më tej se, AK e ka cituar nenin 3.16 të Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik, por nuk ka dhënë arsye ne cilat aspekte nuk është zbatuar kjo dispozitë duke theksuar se në situata analoge (të ngjashme) autoritete tjera kontraktuese kanë vepruar ndryshe, ngase ka kërkuar sqarime. Për më tepër, për ankuesin konsiderohet paradoksale dhe e pashpjegueshme cilësimi i parashtruesit si "Palë pa interes" andaj ka kërkuar që vendimi i atakuar në ketë çështje juridiko administrative, të anulohet.

Në kontekstin e veprimeve dhe pohimeve të palëve, Paneli konsideron (natyrisht nga pikëpamja e tij/sajë) se çështja kontestuese në rastin konkret, kryesisht i referohet statusit të ankuesit, respektivisht faktit nëse ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me dispozitën e nenit 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP. Në të vërtetë, statusi i palës, paraqet çështje substanciale në ketë proces ankimor, përderisa është kusht (prezumim) i domosdoshëm, i karakterit procedural nga i cila varet e drejta e pjesëmarrjes ose jo në një çështje juridiko administrative, duke e nënkuptuar prokurimin publik si të tillë, në vështrim të parimeve bazë të legjislacionit. Me synimin që çështja lëndore të jetë analizuar në mënyrë të drejtë dhe objektivisht, Paneli mori në konsideratë krahas pohimeve të palëve, mes tjerash dhe nenin 3.16 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik, disa nga dispozitat relevante të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, krahas atyre të LPP.

Në ketë rast, paragrafi 3.16. i Rregullores së cituar, përmban rregullin si në vijim, cituar: "Të gjithë Operatorët Ekonomik që janë të regjistruar dhe janë aktiv në platformë të prokurimit elektronik, për çfarëdo ndryshimi të të dhënave të biznesit në Agjencion për Regjistrim të Bizneseve (ARBK) dhe Administratë Tatimore (ATK), që për pasoje ka ndryshim/ndërrim të emërtimit, (emri numrit fiskal/biznesit, (numri identifikues për nevojat e sistemit tatimor statutin e biznesit ose (riorganizimi, transformimet statusore shuarjen e biznesit janë të obliguar që menjëherë vetë t'i përditësojnë të dhënat në platformë të prokurimit elektronik. Përditësimi i të dhënave bëhet në pajtim me udhëzimet e KRPP-së, nëpërmjet tavolinës ndihmëse ose udhëzuesit të publikuar në web-faqe të prokurimit elektronik".

Është fare e qartë dhe jo kontestuese, se sipas rregullit si më sipër, operatorët ekonomik të cilët figurojnë në platformë të prokurimit elektronik, ndryshimet eventuale përkitazi me të dhënat e entitetit afarist, qofshin ato ndërrimi i emërtimit, numrit fiskal, statuti i biznesit ose shuarja, janë të obliguar që t'i përditësojnë menjëherë edhe në platformë të prokurimit elektronik. Në kuptimin e njohurive të përgjithshme, një platformë e tillë (jo vetëm për prokurimin) nënkupton një mekanizëm inovativ të komunikimit, që përmban informacione të ndryshme, disponon me evidencën e të dhënave, mundëson dorëzimin efektiv të aplikacioneve e tjera dhe natyrisht se korrigjimi i të dhënave nënkupton dhe bartjen e informacioneve në kohë. Mirëpo duhet pasur kujdes se paku për gjërat si në vijim:

a. bartja e informacioneve në kohë (siç thuhet: menjëherë) nuk e privon asnjë subjekt (fizik dhe/ose juridik) nga një e drejtë e cila i garantohet me legjislacionin në fuqi;

b. shprehja "t'i përditësojnë menjëherë" nuk është e precizuar andaj nuk mund të përdoret për eliminim absolut të ndonjë OE nga një proces prokurimi;

c. paragrafi i cituar përmban shprehje dhe nocione, të cilët janë të veçanta krahasuar me njëra tjetrën si nga kuptimi ashtu dhe efektet juridike që i prodhojnë. Prandaj (natyrisht sipas mendimit të Panelit) ndërrim i emrit të një entiteti afarist, nuk e mohon ekzistencën apo subjektivitetit juridik. Po ashtu, statuti është akt juridik/organik i një entiteti ndryshimi i të cilit po ashtu nuk e mohon ekzistencën e subjektivitetit juridik. Kurse, shuarjen e biznesit (pavarësisht se radhitet brenda fjalisë) nënkupton faktin se subjekti juridik (entiteti) pushon së ekzistuari (megjithëse shuarja është proces). Prandaj sipas gjykimi të pavarur të këtij Paneli, çdo

entitet afarist i cili aplikon për ndryshime eventuale të emrit, numrit fiskal dhe/ose statutit, vazhdon kontinuitetin e subjektivitetit juridik dhe si rrjedhojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga çfarëdo raporti eventual kontraktues i atribuohen të njëjtit.

Bazuar në mendimin si më sipër të këtij Paneli, rezulton se ankuesi ka statusin e palës në ketë çështje juridiko administrative, respektivisht në ketë aktivitet të prokurimit dhe nuk do duhej trajtuar palë pa interes. Fakti se AK nuk ka pranuar ofertë apo dokument të vulosur me vulën me emrin Foleja Motors LLC nuk e mohon ekzistencën e subjektit ekzistues andaj nuk ka kuptimin e palës pa interes. Aq më tepër, në kuptim të nenit 7, po të kësaj Rregullore, lidhur me nenin 10 dhe 11 të LPP, në shumë raste nuk bëhen publike informata të konsiderueshme të cilat klasifikohen si sekrete, ndoshta me më rendësi se sa emri tregtar dhe ndryshimet e cituara. Nga ana tjetër, OSHP nuk i interpreton Ligjet tjera të cilat i referohen një fushëveprimi tjetër, mirëpo është fakt notor se veprimet eventuale të cituara si më sipër, padyshim se i nënshtrohen një procesi administrativ para Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, e cila udhëheq me mënyrën dhe procedurën e regjistrimit dhe mban regjistrin e entiteteve afariste, sipas nenit 15 lidhur me nenin 17 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Në vendimin e AK thuhet po ashtu se "Certifikata e Biznesit të OE: Foleja Motors e ngarkuar në kërkesën për rishqyrtim mban datën 23.05.2023 ndërsa aktiviteti i prokurimit është publikuar me datën 13.06.2023". Mirëpo nuk mund të mohohet fakti se në ketë aktivitet të prokurimit ka aplikuar OE Auto Shtëpia Siqani SHPK, i/e cila ka hyrë në procesin e ndërrimit të emrit, efektet e të cilit veprim nuk krijojnë si pasojë dhe mohimin apo shuarjen e subjektivitetit të ankuesit. Në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar të datë 25.08.2023, thuhet, cituar: " Tenderi juaj është refuzuar për të gjitha pjesët/lotët që keni ofertuar për arsye: Ju keni ofertuar me emrin e biznesit Auto Shtëpia Siqani SHPK dhe të gjitha dokumentet janë me ketë emër si dhe të vulosura me ketë emër ndërsa me nr. tuaj të biznesit në ARBK figuron biznesi me emër tjetër (pra biznesi me emrin Auto Shtëpia Siqani SHPK nuk figuron në ARBK). Mirëpo shprehja *palë pa interes*, sipas kuptimit që i është dhënë nga AK kryesisht në kontekstin e nenit 3.16 të Rregullores për Prokurimin Publik, nuk e mohon kontinuitetin e subjektivitetit juridik të palës dhe nuk është në harmoni me paragrafin 1.26. të nenit 4, të LPP, sipas të cilit Palë e interesuar është "personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues..." Në Raportin e eksperti shqyrtues duhet veçuar tri konstatime, si në vijim:

1. "...OE ankues ka llogari të hapur në platformën e e-prokurimit me emrin Foleja Motors LLC, ndërsa në ketë aktivitet të prokurimit i ka dorëzuar të gjitha dëshmitë me emrin tregtar Auto Shtëpia Siqani... OE ankues me 23.05.2023 është pajisur me certifikatën e re të ARBK-së, ku e ndërron emrin tregtar dhe e merr emrin Foleja Motors LLC

2. "...data e publikimit të njoftimit për kontratë për ketë aktivitet të prokurimit është data 13.06.2023 që rezulton se OE ankues ka qenë i pajisur me certifikatën e re me emrin Foleja Motors, ndërsa me certifikatën e TVSH-së është pajisur me datën 10.08.2023

3. "...me vet faktin se OE ankues e ka dorëzuar certifikatën e biznesit me emrin Auto Shtëpia Siqani, AK-ja nuk e ka parë të arsyeshme të kërkoj sqarime lidhur me ketë çështje dhe njëherit eksperti shqyrtues vlerëson se me të drejtë e ka eliminuar sepse në ketë rast kërkesa për sqarime dhe plotësim të dokumentacionit, do të thotë ndryshim material i ofertës dhe bije në kudër shtim me nenin 59 të LPP".

Duke ju referuar shpjegimeve, të cilat ky raporti i përmban, Paneli konsideron se shpjegimet e dhëna, e të klasifikuara si më sipër në pikat 1 dhe 2, vërtetojnë kontinuitetin e subjektivitetit juridik të ankuesit, pa nevojë që ato të qartësohen sërish. Por paneli vlerëson se është i gabuar mendimi i ekspertit se "kërkesa për sqarime dhe plotësim të dokumentacionit, do të thotë ndryshim material i ofertës dhe bije në kundërshtim me nenin 59 të LPP" sepse: a) as në kontekstin e pohimeve ankimore e as Vendimit të AK, nuk bëhet fjalë për ndryshim material të ofertës; b) ndryshimi material i referohet nenit 27, 28 dhe 29 dhe 59 të LPP; c) në ketë proces ankimor çështja kyçe ka të bëjë me faktin a është apo jo, ankuesi palë pa interes. Kurse kërkesa eventuale për sqarime shtesë nuk ka të bëjë me përmbajtjen e ofertës (tenderit) por me statusin e Ankuesit si palë dhe si rrjedhojë nuk aplikohen normat e karakterit material por procedural.

- Përfundim -

Është jo kontestues fakti se AK e ka eliminuar ankuesin nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se i njëjti është palë pa interes, meqë gjatë rrjedhës së procesit të prokurimit ka ndryshuar emri tregtar i të njëjtit. Ky fakt nuk është kontestues as për ekspertin shqyrtues e as për ketë Panel, mirëpo eliminimi ankuesit për shkaqet e cituara si më sipër, së paku nga pikëpamja e këtij Paneli, nuk është në harmoni me LPP dhe me parimet bazë të legjislacionit përkitazi me statusin e palës. Prandaj arsyet që vendimi i atakuar i përmban, nuk janë relevante, të qëndrueshme dhe në pajtim të plotë me normat e LPP për eliminimin e cilit do OE nga një aktivitet i prokurimit dhe secili entitet i administratës shtetërore, i cili vepron nga cilësia e AK duhet të ketë kujdes në precizimin korrekt dhe të drejtë të statusit të një subjekti në procesin e prokurimit publik, përderisa statusi i një pale i nënshtrohet dispozitave me karakter detyrues (kogent), respektimi i të cilave promovon njëherësh dhe integritetin e prokurimit publik.

Lidhur me këtë, OSHP me datë 20.10.2023 i ju është drejtuar KRPP-së me kërkesën për sqarime si në vijim: *Sqarimi i kërkuar ka te beje me procedurën apo mënyrën e përditësimit të të dhënave në sistem të prokurimit elektronik nga ana e Operatorëve Ekonomik te cilët bëjnë ndryshime ne ARBK dhe ATK, apo me sakte se kur dhe si kane mundësi qe OE vetë ti bëjnë përditësimet brenda sistemit te prokurimit elektronik.* Ndërsa me datë 23.10.2023 është pranuar përgjigjja si në vijim: *"Lidhur me shkresën tuaj më poshtë, paragrafi 3.16, të cilit ju keni referuar, është pjesë e Nenit 3, Kërkesat për përdoruesit e sistemit të prokurimit elektronik të Rregullores Nr. 001/2022 per Prokurimin Publik. Në lidhje me këtë paragraf dhe sqarimin e kërkuar, ju informojmë që përditësimi i të dhënave në sistem të prokurimit elektronik bëhet vetë nga Operatorët Ekonomik – nëpërmjet menysë "Të dhënat e mia" në kuadër të llogarisë së operatorit ekonomik. Përditësimi bëhet në pajtueshmëri me udhëzimet në manualin udhëzues të cilin mund ta gjeni të bashkangjitur në këtë e-mail. Obligimi për përditësimin e të dhënave sipas paragrafit 3.16 dhe udhëzimeve si në manualin e bashkangjitur,* ***mund të bëhet vetëm nëse të dhënat e OE janë përditësuar paraprakisht në ATK, sepse sistemi i prokurimit elektronik komunikon apo shkëmben të dhëna vetëm me ATK."***

Andaj duke u referuar komunikimeve si më sipër, mund të kuptohet që edhe në aspektin teknik ndryshimi i emrit në platformën e-prokurimi nuk mund të realizohet pa përfunduar të gjitha procedurat përbrenda autoriteteve kompetente, kështu që pajisja e ankuesit me certifikatën e TVSH-së në rastin konkret mund të ketë ndikuar në vonesën e ndryshimit të emrit që nga data e ndryshimit të tij në ARBK.

Duhet shpjeguar në ketë rast se, mendimi i një eksperti nuk krijon efekte detyruese për organin vendimmarrës dhe së këndejmi Paneli ka shprehur mendimin e pavarur të tij në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 104 të LPP, përderisa vlerat provuese një raporti rezultojnë nga administrimi, shqyrtimi dhe vlerësimi i të gjitha fakteve dhe provave përkitazi me veprimet dhe rrjedhën e procesit të prokurimit dhe kërkesat e legjislacionit, të cilat Paneli i vlerësoi mbi bazën e gjykimit të pavarur të tij/sajë. Mirëpo Paneli e obligon AK që gjatë procedurave të rivlerësimit ti drejtohet Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) apo ndonjë entiteti tjetër me kompetencë relevante lidhur me faktin se ankuesi e ka apo jo statusin e palës dhe në kontekstin e rrethanave të përshkruara si më sipër a do të kishte të drejtë ta vazhdoj pjesëmarrjen në ketë aktivitet të prokurimit.

Në ketë rast dhe në kontekstin e natyrës së kësaj lënde, Paneli shpjegon po ashtu se sistemi i prokurimit publik duhet ti përmirësoj në çdo aspekt kapacitet profesionale dhe të përgatitet për proceset e integrimit sepse praktikat e mira dhe standardet e prokurimit ndërkombëtar, natyrisht pa pretenduar assesi se vendimet e këtij Organi karakterizohen me profesionalizëm absolut. Prandaj Paneli konsideron se ka vendosur në mënyrën e duhur dhe të drejtë, kurse AK ka të drejtë ti evitoj në procesin e ri-vlerësimit të gjitha të metat e konstatuara, natyrisht sipas zgjidhjeve diskrecionale të tij. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në këtë proces të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 1 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Agjencia Qendrore e Prokuimit**
- OE - **FOLEJA MOTORS L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së:

Republika e Kosovës
Republika Kosova-RepublicofKosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo za Finansije, rada i transfera Ministry of Finance, Labor and Transfers

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT

CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Furnizim me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës

Nr. i prokurimit	UA/2016-23-5626-1-1-1

Lot 1, Lot 2, Lot 3, Lot 4, Lot 5, Lot 6 dhe Lot 9.

		Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës					
Nr.	Pjesa/Loti Furnizim me vetura për Institucionet e Republikës së Kosovës	" Auto Mita " SH.P.K. Magjistralja Prishtine-Shkup, Preoc, GRACANICA; 600793724.	KOSOVA MOTORS J.S.C. SH.A. Graçanicë, Preoc 811277591	PORSCHE KOSOVA SH.P.K; P N, LLAPNASELLË; 600162028	Mercom Company SH.P.K. 20/3 FAZLI GRAJÇEVCI, PRISHTINË 810298548	Auto Shtëpia Siqani SH.P.K. Prishtine; 811493155	Ideal Shala B.I. Parku i Biznesit Drenas, Drenas 810252114
1.	Lot 1	€ 252,600.00	-	-	-	€ 222,750.00	€ 262,500.00
2.	Lot 2	€ 436,480.00	-	-	**€ 413,050.00 (100pikë)**	€ 390,940.00	-
3.	Lot 3	€ 347,480.00	-	-	-	€ 287,980.00	€ 380,800.00

4.	Lot 4	**€ 218,400.00 (100pikë)**	-	-	-	€ 177,700.00	-
5.	Lot 5	€ 196,560.00 (99.23pikë)	€ 204,750.00 (92.56pikë)	€ 206,010.00 (96.79pikë)	**€ 197,505.00 (99.66pikë)**	€ 163,080.00	€ 201,600.00 (97.47pikë)
6.	Lot 6	-	-	-	**€ 1,286,040.00 (100pikë)**	€ 1,251,040.00	-
7.	Lot 9	**€ 87,360.00 (100pikë)**	-	-	-	€ 71,080.00	-

Agjencia Qendrore e Prokurimit shpërblen me dhënie kontrate operatorët ekonomik:

- Për Lot 2 OE **Mercom Company SH.P.K.**, 810298548 me vlerë të ofertës **413,050.00€.**
- Për Lot 4 OE **"Auto Mita" SH.P.K.**, 600793724 me vlerë të ofertës **218,400.00€.**
- Për Lot 5 OE **Mercom Company SH.P.K.**, 810298548 me vlerë të ofertës **197,505.00€.**
- Për Lot 6 OE **Mercom Company SH.P.K.**, 810298548 me vlerë të ofertës **1,286,040.00€.**
- Për Lot 9 OE **"Auto Mita" SH.P.K.**, 600793724 me vlerë të ofertës **87,360.00€.**

Në mungesë të ofertave të përgjegjshme Agjencia Qendrore e Prokurimi anulon pjesët: Lot 1 dhe Lot 3.

Data: 29.11.2023

Emri dhe mbiemri i ZPP: **Emine Masurica**

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

29.11.2023, Prishtinë

Nga Autoriteti Kontraktues: Agjencia Qendrore e Prokurimit, Ndërtesa e Gërmisë kati V.

Për Operatorin Ekonomik: Auto Shtëpia Siqani SH.P.K. Prishtine; 811493155

Nr. i prokurimit	**UA/2016-23-5626-1-1-1**

Titulli: Furnizim me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:
Oferta e juaj është vlerësuar si oferte e papërgjegjshme pasi që keni dorëzuar ofertë me emrin e vjetër edhe pse ndryshimi në ARBK është bërë me datën 23.05.2023 ndërsa ofertimi është bërë me datën 25.07.2023.
Bazuar në vendimin e OSHP-së me nr. 2023/0670 kemi kërkuar interpretim nga KRPP të cilët kanë refuzuar të interpretojnë këtë çështje, gjithashtu kemi kërkuar interpretim nga MTI/ ARBK të cilët kanë deklaruar: "Vlen të theksohet që përfaqësuesit e autorizuar të Shoqërisë Tregtare, kanë dorëzuar në ARBK certifikatën origjinale të biznesit me emrin AUTO SHTËPIA "SIQANI" sh.p.k si dhe kanë përfunduar të gjitha procedurat ligjore për ndryshimin e emrit të biznesit." Me këtë rast mund të konsiderohet si tentim për mashtrim nga ju pasi që në ofertën e tuaj keni ngarkuar certifikatën e biznesit që tashmë nuk e kishit origjinalin por keni dorëzuar vetëm kopje të atij dokumenti si dhe keni dorëzuar sigurim të tenderit, deklaratën nën betim, deklaratën për specifikacion teknik, deklaratën për liferim, deklaratën për garancion, autorizimin dhe çdo dokument tjetër në emrin e vjetër edhe pse tashmë në kohën kur është bërë dorëzimi i ofertave (për më tepër 2 muaj më herët) kishit ndryshuar emrin e biznesit. Duke pasur parasysh që kjo është ndoshta një tentim për mashtrim apo ndoshta një gabim i juaj konsiderojmë që përgjegjësia dhe pasojat duhet ti bartë ju duke u eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

SEJDIU & QERKINI
SHOQËRIA E AVOKATËVE
LAW FIRM

Lagja Veternik, Kompleksi Banesor EXDC 3
Llamella 10, Kati 6, Nr. 18
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Web: www.sq-law.com
E-mail: info@sq-law.com
Tel: +383 (0) 45 40 77 40

PËR	**AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT**
NGA	**FOLEJA MOTORS LLC (ish Auto Shtëpia Siqani sh.p.k.),** një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, me numër unik identifikues 811493155 dhe seli në: Llapllasellë, Magj.Prishtinë-Shkup Km 8, p.n, Republika e Kosovës, e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve Sejdiu & Qerkini sh.p.k., me seli në: Lagja Veternik, Kompleksi Banesor EXDC3, Blloku 10, Kati 6, Nr. 18, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.
DATA	30 nëntor 2023
LËNDA	**KËRKESË për Rishqyrtim të Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar nga tenderi nr. i prokurimit UA/2016-23-5626-1-1-1, datë 29.11.2023.**

I. Hyrje

Foleja Motors LLC - ish Auto Shtëpia Siqani sh.p.k. (këtu e tutje "Parashtruesi") në cilësinë e tenderuesit ka aplikuar në tenderin e Autoritetit Kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit i cili identifikohet me numrin UA/2016-23-5626-1-1-1. Ky aktivitet titullohej: Furnizimin me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës.

Parashtruesi kishte ofertuar në 1, 2, 3, 4, 5, 6, 9 pjesët/lotet e këtij tenderi.

Me datë 25.08.2023, Parashtruesi nga ana e Autoritetit Kontraktues pranon Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar, me anë të së cilës siç edhe nënkuptohet nga titulli njoftohet se është eliminuar nga tenderi i autoritetit kontraktues.

Duke mos u pajtuar me vendimin e Autoritetit Kontraktues, Parashtruesi, kishte paraqitur kërkesën për rishqyrtim të letrës standarde. Autoriteti Kontraktues duke vendosur sipas kërkesës së Parashtruesit, kishte marrë vendimin e tij me anë të së cilit, atë ankesë e kishte refuzuar.

Në përputhje me këshillën juridike, Parashtruesi kishte paraqitur ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit – OSHP. Ky organ pas shqyrtimit të ankesës si dhe pas mbajtjes së seancës publike, me datë 27.10.2023 morri vendimin e identifikuar si OSHP: 2023/0670, me anë të së cilës është Aprovuar Pjesërisht Ankesa e Parashtruesit dhe aktiviteti i prokurimit është kthyer në Rivlerësim.

Provë 1: Vendim i OSHP-së 2023/0670, datë 27.10.2023.

Në procedurën e rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues me datë 29.11.2023, nxori Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar. Këtë dokument Parashtruesi e ka pranuar me datë 29.11.2023.

Provë 2: Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, datë 29.11.2023.

Parashtruesi nuk pajtohet me Letrën e Autoritetit Kontraktues, ashtu që, në përputhje me këshillën juridike si dhe brenda afatit ligjor, paraqet këtë Kërkesë për Rishqyrtim të Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar, datë 29.11.2023, përmes së cilës të njëjtën e konteston në tërësi dhe e konsideron si tërësisht të pabazuar.

II. Baza Juridike

Si bazë juridike, për hartimin dhe paraqitjen e kësaj kërkese shërbeu:

- Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje "LPP");
- Ligji Nr. 04/L -237 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje "LPP I");
- Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje "LPP II");
- Ligji Nr. 05/L-092 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje "LPP III");
- Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (këtu e tutje "LPPA");
- Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (këtu e tutje "Rregullorja").

III. Arsyetimi

3.1. Eliminimi i pabazuar

Autoriteti kontraktues vendimin e tij për ta eliminuar Parashtruesin e bazon nën pretendimet se *"...pasi që keni dorëzuar ofertën me emrin e vjetër edhe pse ndryshimi në ARBK është bërë me datë 23.05.2023 ndërsa ofertimi është bërë me datën 25.07.2023"*

"... refuzimin për interpretim nga KRPP..."

"interpretimin nga MTI –ARBK" gjë që ka qenë e pakontestueshme sepse vetë Parashtruesi në procedurën e mëhershme pranë Autoritetit Kontraktues këtë gjendje e ka paraqitur me prova të detajuara si dhe *"... nën pretendimin për tentim të mashtrimit..."*

Parashtruesi, asesi nuk pajtohet me këtë vlerësim të Autoritetit Kontraktues dhe për hirë të qartësisë, do të paraqesë përsëri gjithë rrjedhën e kësaj procedure.

Sipas Rregullores, konkretisht Nenin 3.16 të saj, në momentin kur një Operator Ekonomik ka ndryshime të të dhënave të regjistruara në ARBK dhe ATK duhet të ndjek këtë procedurë:

> *"Të gjithë Operatorët Ekonomik që janë të regjistruar dhe janë aktiv në platformë të prokurimit elektronik, për çfarëdo ndryshimi të të dhënave të biznesit në Agjencion për Regjistrim të Bizneseve (ARBK) dhe Administratë Tatimore (ATK), që për pasoje ka ndryshim/ndërrim të emërtimit, numrit fiskal/biznesit, statutin e biznesit ose shuarjen e biznesit janë të obliguar* ***që menjëherë vetë t'i përditësojnë*** *<u>të dhënat në platformë të prokurimit elektronik.</u> Përditësimi i të dhënave bëhet në pajtim me udhëzimet e KRPP-së, nëpërmjet tavolinës ndihmëse ose udhëzuesit të publikuar në web faqe të prokurimit elektronik."*

Parashtruesi Autoriteti të nderuar kontraktues, me respekt i kërkon që gjatë shqyrtimit të kësaj kërkese të bëjë një interpretim gjuhësor të kësaj dispozite. Krahas kësaj, poashtu, ju lusim të keni parasysh edhe interpretimin që KRPP-ja, e ka bërë në kërkesën e OSHP-së, të cilën mund ta gjeni në paragrafin e fundit të faqes 6 të vendimit të OSHP-së (prova 1). Në këtë paragraf ndër të tjera thuhet se:

> *"...Obligimi për përditësimin e të dhënave sipas paragrafit 3.16 dhe udhëzimeve si në manualin e bashkangjitur,* ***mund të bëhet vetëm nëse të dhënat e OE janë përditësuar paraprakisht në ATK, sepse sistemi i prokurimit elektronik komunikon apo shkëmben të dhëna vetëm me ATK".***

Parashtruesi nuk ka njohuri se cila ka qenë kërkesa për interpretim që Autoriteti Kontraktues ia ka parashtruar KRPP-së, mirëpo siç shihet nga vendimi i OSHP-së dhe nga pjesa e cituar më lartë, KRPP-ja, veçse ka dhënë interpretimin e saj për çështjen kryesore të këtij rasti. Nga ai interpretim, rezultati që vijon është ky, për sistemin elektronik të prokurimit të dhënat e një operatori ekonomik konsiderohen të ndryshuara vetëm kur ato **përditësohen në ATK**. Nga kjo poashtu rezulton se (gjithnjë sa i përket sistemit elektronik të prokurimit) ndryshimi i të dhënave në ARBK nuk është gjë tjetër veçse rrugë që duhet kaluar për tu plotësuar kushtet që të aplikohet për ndryshim në ATK e pastaj në E-Prokurimi. Për fund është e qartë se obligimi i vetëm i Operatorit Ekonomik është që **MENJËHERË** pasi përditësimit të ATK, të përditësojë të dhënat në E-Prokurim dhe këtë gjë e ka bërë Parashtruesi.

Siç edhe do të dëshmohet në vijim, veprimet e Parashtruesit janë konform rregullores, interpretimit të KRPP-së dhe se vendimi i Autoriteti Kontraktues është në kundërshtim me rekomandimet dhe të gjeturat e OSHP-së si dhe vetë interpretimin e KRPP-së.

Parashtruesi konkretisht aksionarët e tij, për qëllime afariste, kanë vendosur që emrin e kompanisë së tyre ta ndryshojnë nga Auto Shtëpia Siqani sh.p.k., në Foleja Motors LLC. Siç parashihet edhe me ligj, këtë kërkesë për ndryshim të emrit, fillimisht e kanë bërë pranë ARBK-së.

Një ndryshim i tillë, ka përfunduar me sukses pranë ARBK-së, me datë 23.05.2023.

Provë 3: Certifikata e Biznesit dhe informatat e tij, datë 23.05.2023.

Duke mos lënë vend për interpretime, Parashtruesi sqaron se është ndryshuar vetëm emri i biznesit dhe të gjitha çështjet e tjera kanë mbetur të njëjta. Pra, nuk është hapur biznes i ri dhe Foleja Motors LLC identifikohet me numrin e njëjtë unik (811493155) siç e ka pasur edhe emërtimi i mëhershëm Auto Shtëpia Siqani sh.p.k. Me këtë vërtetohet se kemi të bëjmë me subjektin e njëjtë juridik, i cili ka pësuar ndryshime të vogla korporative (emrin).

Pas realizimit të këtij ndryshimi korporativ, Parashtruesi kishte tentuar emrin e ri ta evidentoj edhe në E-Prokurimi, mirëpo ky ndryshim nuk ishte i mundur (shih pjesën e cituar të KRPP-së), meqë para kësaj duhet të bëhej edhe ndryshimi pranë Administratës Tatimore të Kosovës – ATK.

Marrë parasysh atë që u tha më lartë, si dhe bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Parashtruesi me datë 25.05.2023 (vetëm 2 ditë pasi merr konfirmimin nga ARBK), pranë ATK-së, paraqet kërkesën për ndryshim të emrit dhe marrjen e numrit të ri fiskal.

Provë 4: Aplikimi pranë ATK-së, datë 25.05.2023

Siç edhe dihet, kjo procedurë para ATK-së, nuk përfundohet shpejtë, ashtu që, Parashtruesi meqë nuk ka mundur të ndërroj emrin në E-Prokurimi (për arsyet e cekura më lartë) dhe në tenderin e shpallur ka aplikuar me emrin që evidentohet në E-Prokurim dhe dokumentet e tjera - në emër të Auto Shtëpia Siqani sh.p.k.. E tërë kjo për shkak se ndryshimi i emrit nuk është realizuar në tërësi pranë të gjitha institucioneve shtetërore.

Me datë 10.08.2023, Parashtruesi me sukses përfundon të gjitha procedurat pranë ATK-së dhe rrjedhimisht merr certifikatën e re.

Provë 5: Certifikata e ATK-së, datë 10.08.2023.

Në të njëjtën datë, pra 10.08.2023, Parashtruesi bënë edhe ndryshimin e emrit në E-Prokurim, meqë tani kjo i është lejuar nga ana e sistemit. Kjo gjë mund të vërtetohet shumë lehtë në sistemin e E-Prokurimit (për çdo person që ka dyshime dhe qasje në sistem). Pra, Parashtruesi me përgjegjësi të plotë deklaron se në sistemin e E-Prokurimit me datë 10.08.2023, ka bërë ndryshimin e emrit nga Auto Shtëpia Siqani sh.p.k. në Foleja Motors LLC.

Si përfundim cekim se e gjithë kjo procedurë ka shkuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe se eliminimi i Parashtruesit për këtë arsye nga Autoritetit Kontraktues është tërësisht i pabazuar, i paqëndrueshëm, në kundërshtim me vendimin e OSHP-së si dhe në kundërshtim me sqarimin e KRPP-së.

3.2.Mungesa e kërkesës për sqarim

Paragrafi 2 i Nenit 59 të LPP-së, parasheh se:

> *"2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve.*